REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

**Nr.** 90 **prot.** **Kamëz, më** 23.10.**2025**

**V E N D I M**
**Nr.** 76 **.Datë** 23/10 **2025**
**MBI**

**"MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN 2025-2030"**

**Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.10.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.71 Datë 21.10.2025** në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ligji Nr.10221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.Ligji Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë", ligji 22/2018 "Për Strehimin Social" ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë si dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror", **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e "Planit Vendor të Veprimit për Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2025-2030".

2. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KAMËZ

**KRYETAR KËSHILLI**
**HYSEN KOLDASHI**



**BASHKIA KAMËZ**

**DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE**

# Plani Vendor i Veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian

**2025-2030**

*info@kamza.gov.al*

# Plani Vendor i Veprimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Kamëz

# 2025-2030

*Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Kamëz (2025-2030) u mundësua në kuadër të Planit Social të miratuar në Bashkinë Kamëz 2024-2026.*

# Tabela e përmbajtjes

HYRJE....3

KAPITULLI I. QASJA METODOLOGJIKE....5

1.1 Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian....5

1.2 Metodologjia....6

1.3 Aktorët e përfshirë....7

1.4 Kuadri ligjor dhe strategjik....8

KAPITULLI II. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE....10

2.1 Situata aktuale....10

2.2 Regjistrimi në Gjendjen Civile....11

2.3 Arsimimi....12

2.4 Kujdesi shëndetësor....13

2.5 Punësimi, formimi dhe edukumi profesional....14

2.6 Strehimi....16

2.7 Mbrojtja sociale....17

KAPITULLI III. PLANI I VEPRIMIT.... 19

3.1 Vizioni.... 19

3.2 Qëllimet strategjike dhe objektivat....19

3.3 Kosto për zbatimin e planit....20

3.4 Monitorimi dhe vlerësimi i planit....52

## Hyrje

Plani Vendor i Veprimit për Komunitetin Lokal Rom dhe Egjiptian është një instrument planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtër sfidat me të cilat përballen të dy komunitetet duke synuar në arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të lartë integrimi të anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal. Ky plan shërben si një mekanizëm orientues i veprimeve që aktorët vendorë dhe rajonalë duhet të ndërmarrin për të adresuar sfidat dhe barrierat që pengojnë dy komunitetet në sigurimin e një jete dinjitoze. Dokumenti i planit fillimisht jep një pasqyrë të situatës aktuale të komunitetit Rom dhe Egjiptian lidhur me sfidat kryesore (ku jemi aktualisht) në lidhje me: a) regjistrimin në gjendje civile; b) arsimimin; c) kujdesin shëndetësor; d) punësimin, formimin dhe edukimin profesional; e) strehimin; f) mbrojtjen sociale. Pas analizës së situatës aktuale, plani propozon vizionin për zhvillimin e dy komuniteteve (si duam ta shohim komunitetin Rom dhe Egjiptian pas disa vitesh?) dhe cilat janë veprimet që duhet të ndërmarrim për të arritur aty ku dëshirojmë në të ardhmen, Plani i veprimit paraqet qëllimet strategjike dhe objektivat specifikë për gjashtë fushat, ndërsa çdo objektiv ka të renditura projektet dhe hapat e veprimit konkret, të cilat janë të detajuara në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet aktorëve lokalë dhe rajonalë, implikimet financiare, burimet e të ardhurave si dhe treguesit e performancës dhe afatet kohore. Plani i veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian është një instrument praktik dhe relativisht i thjeshtë për t'u përdorur jo vetëm nga aktorët publik por edhe nga aktorët e shoqërisë civile, grupet e ndryshme sociale, në kontributin e tyre për adresimin e sfidave sipas veprimeve të parashikuara në Plan, duke bërë të realizueshëm edhe vizionin e artikuluar në dokument. Koordinimi i përpjekjeve ndërmjet aktorëve lokalë për zbatimin e këtij plani është tejet i rëndësishëm duke marrë në konsideratë faktin që një dokument i tillë reflekton nevojat dhe preferencat e anëtarëve të dy komuniteteve dhe të aktorëve të tjerë lokalë. Procesi i hartimit të planit ka patur natyrë të lartë pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse dhe dokumenti final është rezultat i studimeve të ndryshme të realizuara nga aktorë të ndryshëm publik dhe privat në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz. Një plan strategjik është jo vetëm një parakusht për të mobilizuar burime të tjera financimi dhe akses në fonde nga donatorë të ndryshëm, por edhe një tregues tepër i rëndësishëm në përpjekjen për të rritur mirëqenien, integrimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këto grupe në nevojë. E thënë ndryshe, politikat në nivel vendor të orientuara drejt përfshirjes sociale kanë një efekt pozitiv jo vetëm në

adresimin e nevojave dhe sfidave me të cilat përballen këto komunitete, por edhe më tej në integrimin e qëndrueshëm në fushat prioritare si punësimi, arsimi, strehimi, mbrojtja sociale, shëndetësia.

Plani Vendor i Veprimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Kamëz fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuara edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, të lidhura ngushtë me kontekstin vendor. Ky plan veprimi është hartuar me synimin që të shërbejë si instrument për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në lidhje me integrimin social dhe ekonomik të dy komuniteteve në Bashkinë Kamëz. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: regjistrimi civil, arsimimi, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të problematikave shumëdimensionale të dy komuniteteve. Ky dokument është i organizuar në tre kapituj kryesorë. Në kapitullin e parë përshkruhet qasja metodologjike e procesit planifikues të këtij dokumenti dhe aktorët e përfshirë në hartimin e këtij plani, parimet e planit dhe kuadri ligjor dhe strategjik. Në kapitullin e dytë paraqitet situata aktuale e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkinë Kamëz sipas gjashtë fushave prioritare të përmendura më sipër. Kapitulli i tretë paraqet deklaratën e Vizionit dhe qëllimet strategjike të planit, i cili vijon me kapitullin e matricës së planit të veprimit që përfshin qëllimet strategjike, objektivat specifikë, aktivitetet sipas fushave prioritare. Rëndësi e veçantë i kushtohet monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit, pasi është tejet e nevojshme dhe e rëndësishme ndjekja e zbatimit të strategjisë për të vlerësuar rezultatet e pritura të objektivave strategjikë.

# Kapitulli I

## 1.1 Parimet udhëheqëse të planit vendor të veprimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian

Në thelb të të gjitha shërbimeve që ofrohen dhe aktiviteteve të planifikuara për komunitetin Rom dhe Egjiptian duhet të merren parasysh të gjitha parimet e mëposhtme duke vënë theksin tek ato parime që synojnë përfshirjen sociale të komuniteteve. Gjithashtu duhet të kemi një qasje ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe që synojnë zhvillimin e partneriteteve publike dhe private mes të gjithë aktorëve apo grupeve të interesit të përfshirë.

Parimi i përfshirjes sociale

Plani vendor i veprimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian i kushton një rëndësi të veçantë nxitjes së përfshirjes sociale. Ky plan me anë të objektivave specifike dhe aktiviteteve të parashikuara synon të nxisë përfshirjen sociale të komunitetit Rom dhe Egjiptian kryesisht në fushën e arsimimit, kujdesit shëndetësor, punësimit dhe edukimit profesional, aksesit në programet e strehimit dhe programet e mbrojtjes sociale.

Parimi i përfshirjes aktive

Plani vendor i veprimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian përpos përfshirjes sociale, vë theksin në nxitjen e përfshirjes aktive të komunitetit rom dhe egjiptian. Plani e veprimit synon nxitjen e komunitetit për tu angazhuar në mënyrë aktive në planet e hartuara në nivel lokal, të cilat përfshijnë të gjitha fushat e sipërpërmendura dhe jo vetëm.

Parimi i mosdiskriminimit

Plani vendor i veprimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në aktivitetet e parashikuara ka në qendër të vëmendjes respektimin e të gjithë të drejtave dhe garantimin e mosdiskriminimit ndaj komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Parimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe zhvillimi i partneriteteve publik-privat

Parimi i nxitjes së bashkëpunimit ndërsektiorial synon zhvillimin e partneriteteve midis aktorëve të ndryshëm lokal dhe qëndror. Gjithashtu synohet të ketë një përfshirje dhe të aktorëve privat, grupet e

shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit dhe veçanërisht vetë komuniteteve apo përfaqësuesëve të tyre.

Parimi i përfshirjes gjinore

Plani vendor i veprimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian thekson rendësinë e integrimit gjinor në të gjitha hapat e planifikimit dhe hartimit të tij. Në komunitetet Rome dhe Egjiptiane grate kanë dy here më shumë pengesa, e para vjen nga raca dhe e dyta nga gjinia. Integrimi gjinor në hartimin e këtij plani përkthehet në të dhëna të sakta të mbledhura ku specifikohet saktë numri i femrave të cilat përfitojnë shërbime të ndryshme.

## 1.2 Metodologjia

Metodologjia e hartimit të Planit Vendor të Veprimit u bazua në një qasje të kombinuar sasiore dhe cilësore, duke përdorur si burime të dhëna parësore (nga komunitetet dhe terreni) dhe të dhëna dytësore (administrative e dokumentare) nga institucionet përkatëse në Bashkinë Kamëz dhe partnerët.

Intervista gjysmë të strukturuara ballë për ballë me anëtarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, sipas një udhëzuesi intervistimi dhe kornize përzgjedhjeje që siguroi larmi në moshë, gjini dhe situata socio-ekonomike.

Studime dhe vizita në terren në familjet Rome dhe Egjiptiane, me vëzhgim të drejtpërdrejtë të kushteve të banimit, aksesit në shërbime dhe nevojave prioritare.

Intervista me institucione vendore dhe OShC si dhe mbledhje të dhënash sasiore administrative, për të pasur panoramë të plotë mbi shërbimet ekzistuese dhe boshllëqet.

Fokus-grupe me banorë të komuniteteve, të organizuara sipas lagjeve/grupeve të synuara, për të testuar gjetjet paraprake dhe për të renditur prioritetet.

Përdorim të të dhënave sasiore nga drejtoritë e Bashkisë Kamëz dhe Sistemi ROMALB për bazëlinë dhe indikatorë monitorimi.

Të dhënat u krahasuan ndër-burime për të rritur besueshmërinë; u respektuan parimet etike (pëlqim i informuar, konfidencialitet) dhe u mbajt balancë përfaqësuese gjeografike e demografike.

### 1.3 Aktorët e përfshirë

Përfshirja e aktorëve kryesorë në zhvillimin lokal është thelbësore për hartimin me sukses të këtij plani zhvillimi. Duke u bazuar dhe në parimin e bashkëpunimit ndërsektorial dhe zhvillimin e partneriteteve publik-privat ky plan veprimi kërkon një qasje ndërsektoriale, shumëaktorëshe dhe gjithëpërfshirëse për vetë kompleksitetin e sfidave dhe problemeve me të cilat përballen. Përfshirja e gjerë e aktorëve përgjatë procesit planifikues është një parakusht i domosdoshëm për të krijuar një model të qëndrueshëm, racional dhe vizionar të planit. Kjo qasje kërkon gjithashtu një përfshirje edhe më të përgjegjshme në procesin e zbatimit dhe të monitorimit të planit, me qëllim që plani të mos jetë thjesht një dokument statik, por të lejojë fleksibilitetin e ndërhyrjeve në koherencë me zhvillimet/ ndryshimet aktuale që paraprin komunitetin. Pra, vizioni për planin është më shumë se një produkt, pasi ai reflekton një qasje më dinamike të mekanizmave institucional në nivel vendor për të adresuar/rishikuar me fleksibilitet nevojat në zhvillim. Grupi lokal i planit të veprimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane kishte në përbërjen e tij si më poshtë:

1. Stafi kyç i bashkisë
    a. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale
    b. Drejtoria e Arsimit, Rinise dhe Sportit
    c. Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile
    d. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
    e. Drejtoria e Pastrimit
    f. Drejtoria e Gjelbërimit
    g. SH. A. Ujësjellës Kanalizime Kamëz
    h. Ndërmarrja e shërbimeve publike
    i. Lagjet/Njësitë Administrative
2. Zyra Arsimore Kamëz
3. Zyra e Punës, Kamëz
4. Organizata SHKEJ

## 1.4 Kuadri Ligjor dhe Strategjik

Legjislacioni kombëtar ka shumë akte ligjore dhe nënligjore që prekin të gjitha sferat e jetës së romëve dhe egjiptianëve duke përfshirë fusha të ndryshme të politikës si të drejtat njerëzore, strehimi, arsimi shëndetësia, punësimi dhe aftësimi, mbrojtja sociale, aksesi në drejtësi, regjistrim civil, kultura etj.

- Ligji Nr.8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".
- LigjiNr.8496 datë 3.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare".
- Ligji Nr.10221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.Ligji Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë".
- VKM Nr.127 datë 11.03.2004 "Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve", i ndryshuar.
- VKM Nr.396 datë 22.08.1994 "Për arsimimin në gjuhën amëtare të personave të pakicave", i ndryshuar.
- Ligji Nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti".
- Ligji Nr.69/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për Gjendjen Civile", të ndryshuar e vendbanimit/adresës së shtetasve".
- VKM Nr.55 datë 06.02.2019 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti".
- Urdhër i Kryeministrit Nr.59 datë 25.03.2019 për "Miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorisë së ndihmës juridike falas".
- VKM Nr.1243, datë 11.12.2009 "Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna, dhe institucionet shtetërore,të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve".
- Udhëzim Nr.284, datë 11.3.2019 "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes së fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes".
- Ligji Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social".
- VKM Nr. 384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim Sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të Procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore".
- Ligji Nr.10/107, datë 30.3.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr.10/383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Udhëri i përbashkët MAS, MB, MSHMS nr 292, datë 28.5. 2019 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës të detyrimit shkollor".

- Udhëzim Nr.17 datë 09.05.2018 "Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimin në kohë të pjesshme në arsimin bazë".
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21 datë 13.8.2020 "Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorimin falas në arsimin parauniversitar".
- Ligji Nr. 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit".
- Ligji Nr.15/2017 datë 16.02.2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë".
- VKM Nr. 882, datë 24.12.2019 "Për mekanizmin e bashkërendimit nderinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe antarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike".
- Ligj Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 104/2014 "Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ligji Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"ndryshuar me ligjin nr. 7/2018, datë 15.2.2018) (i përditësuar, 2018).
- Udhëzimi Nr.21, datë 08.08.2014, "Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë".
- Marrëveshja 3 ministrore (MAS, MShMS, MPB) e bashkëpunimit "Për identifkimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge" nr. 4496, datë 12.06.2015.
- VKM Nr. 449, datë 29.08.2018 "Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të mundshme të Trafikimit".
- VKM Nr. 882, datë 24.12.2019 "Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe antarëve në moshë aktive punë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike".
- Udhëzim Nr.911 datë 27.12.2018 "Për Miratimin e Standartet e Ofrimit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumë disiplinare".
- Udhëzim Nr. 15, datë 15.1.2019 "Për një ndryshim dhe shtesa në udhëzimin nr. 8, datë 25.2.2015 "Për Planifikimin e Fondeve për Ndihmën Ekonomike".
- Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë".

**Kuadri Strategjik**

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2022-2030;
- Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale 2023-2027;
- Plani Vendor i Veprimit për migracionin dhe Diasporën 2022-2026;
- Strategjia e Strehimit Social 2016-2025;

- Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2021–2023;
- Strategjia e Kujdesit Parësor 2020-2025;
- Plani i Veprimit të Promocionit Shëndetësor 2022–2030;
- Strategjia Kombëtare Shëndetësore 2021-2030;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030;
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021 -2030;
- Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030.

# Kapitulli II

## 2.1 Situata aktuale

Bashkia Kamëz ka bërë përpjekjet e saj për të përmirësuar kushtet e jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane, dhe integrimin e tyre në komunitet. Megjithëse ka progres, dhe situata e pakicave rome dhe egjiptiane është përmirësuar gjatë viteve të fundit, mbetet sfidë e mëtejshme varfëria, diskriminimi, integrimi në tregun e punës, regjistrimi në gjendjen civile, qasja në shërbimet shëndetësore dhe përmirësimi i kushteve të strehimit. Gjithashtu konstatohet dhe vazhdon të jetë problematik hendeku i krijuar midis romëve dhe egjiptianëve në raport me joromët në të gjitha fushat jetësore dhe në përfitimin e shërbimeve apo të mirave publike. Në Bashkinë Kamëz u ngrit një grup pune me qëllim monitorimin e të gjithë zonës, për një periudhë tre-mujore, në bashkëpunim me ndërlidhësat në komunitet, keshilltarët, administratorët e lagjeve/njësisë dhe administratoret shoqëror të ndihmës ekonomike për rregjistrimin e familjeve rome dhe egjiptiane në të gjithë teritorin e bashkisë. Nga ky studim u evidentuan 335 familje dhe u krijua një database me të gjithë të dhënat e nevojshme për identifikimin dhe informimin e tyre rreth të gjithë shërbimeve sociale që ofron bashkia përfshirë edhe aplikimin në sistemin kombëtar të ndihmës ekonomike. Megjithatë, romët dhe egjiptianët kanë më pak gjasa për të plotësuar kriteret për përfitimin nga shërbimet sociale (duke përfshirë ndihmën ekonomike) për shkak të mungesës së dokumenteve personale ose të transferimit formal të vendbanimit, analfabetizmit ose paaftësisë për të plotësuar formularët e aplikimit, procedurave tepër të komplikuara, pasja e pronësisë ligjore mbi toka që ata nuk i zotërojnë etj. Ndër të tjera ëshë mundësuar identifikimi i rasteve të paregjistruar në regjistrin e

gjendjes civile si pasojë e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor, lindjeve nga prindër nën moshë, lindjeve në lëvizje, moskuptimit të rëndësisë dhe procedurave të regjistrimit civil apo dhe të vendbanimit, gjendjes së bashkëpunimit dhe koordinimit jo në nivelin e duhur mes strukturave që punojnë drejtëpërdrejt në komunitet etj. Nga ana tjetër, varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë ul ndjeshëm interesin e romëve dhe egjiptianëve për të përfunduar arsimin apo formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit. Edhe pse janë orientuar drejtë zyrës së punës dhe anë referuar në programin e nxitjes së punësimit, ata gjejnë zgjidhje alternative që shpesh janë informale. Sektorët informalë, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo veprimtari të tjera që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë.

Gjithashtu kultura e varfërisë dhe përjashtimit, mungesa e besimit te programet ekzistuese të punësimit, përvojat negative në të kaluarën etj., bëjnë që pjesa më e madhe e romëve dhe egjiptianëve që punojnë në sektorin informal detyrohen të vazhdojnë të mbeten aty (duke pranuar pasiguritë e tregut informal të punës) dhe nuk parapëlqejnë të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit. Megjithatë, bashkia ka luajtur rol kyç në punësimin e tyre, veçanërisht në drejtorinë e pastrim-gjelbërimit, ujësjellësit por edhe në administatën e saj ku janë thuajsë 70 individë të punësuar, ka mundësuar shërbimin falas në çerdhe dhe kopshte me dreke për të gjithë familjet në pamundësi ekonomike. Gjithashtu puna me prindërit dhe familjet e këtij komuniteti është një pjesë e pandarë nga ofrimi i shërbimit në qendërën multifunksionale. Ky shërbim ofrohet në një vijë të drejtë paralele me shërbimin individual. Krahas mbështetjes emocionale qendra ofron takime individuale ose në grup për ngritje kapacitetesh, informim dhe fuqizim për të gjithë prindërit ose familjarë të fëmijëve rome dhe egjiptian me aftësi të kufizuara. Ndër të tjera, ky target grup merr shërbim edhe nga organizata të ndryshme ku mund të përmendim "Caritas" ku marrin vakte ushqimi 54 fëmijë mesatarisht në ditë.

### 1.1 Regjistrimi në gjendje civile

Në Bashkinë Kamëz kemi të dhëna të sakta në lidhje me numrin e familjeve Rome dhe Egjiptiane të cilat jetojnë në territorin juridiksional të Bashkisë Kamëz. Përgjatë vitit 2023 nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale ka nisur proçesi i identifikimit aktiv të familjeve Rome dhe Egjiptiane që jetojnë në Bashkinë Kamëz, identifikim i cili ka përfshirë banorët fizikë dhe juridik të bashkisë.

Nga identifikimi në terren kanë rezultuar 335 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilat jetojnë në territorin e Bashkisë Kamëz. Jo të gjitha familjet e identifikuara janë banorë juridik të Bashkisë Kamëz.

Aksesi në të drejtat politike, sociale, shëndetësore, arsimore është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me regjistrimin civil. Konventa për të drejtat e fëmijëve[1] përcakton se "Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind, dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi".

Disa nga arsyet për mosregjistrimin e fëmijëve të komunitetit në gjendjen civile janë:

1- Lëvizje e shpeshtë brenda dhe jashtë kufinjve dhe shpërnguljet e vazhdueshme;
2- Fëmijë të lindur nga martesat e hershme;
3- Niveli i ulët arsimor;
4- Moskoordinimi ndërinstitucional.

Kryesisht në komunitetin Rom fëmijët nuk regjistrohen menjëherë pranë gjendjes civile duke ju mohuar kështu aksesin në të drejta të ndryshme për aq kohë sa vazhdojnë të paregjistruar. Në Bashkinë Kamëz, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ka një bashkëpunim të ngushtë me gjendjen civile në mënyrë që çdo fëmijë i identifikiuar të regjistrohet.

### 1.2 Arsimimi

Regjistrimi në sistemin arsimor është i rendësishëm jo vetëm për të përmbushur të drejtat kushtetuese apo për të siguruar të drejtën e arsimit për fëmijët por gjithashtu një katalizor për përfshirjen sociale dhe aktive të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Arsimi bazë është i detyruar për çdo fëmijë nga mosha 6 deri në moshën 16 vjeç dhe është përgjegjësi e bashkisë që të sigurojë infrastrukturën dhe kushtet e nevojshme për shkollat, kopshtet dhe çerdhet. Në Bashkinë Kamëz aktualisht kemi 23 shkolla, 22 kopshte dhe 4 çerdhe të cilat përmbushin të gjitha kushtet e nevojshme për një arsim cilësor të fëmijëve.

[1] Neni 7 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve e ratifikuar me Ligjin Nr. 7531 datë 11.12.1991, Fl.Zyrtare Ekstra 89, viti 2013




*Grafiku nr. 1: Paraqitja grafike e regjistrimit të fëmijëve Rom dhe Egjiptian në arsim.*

Nga të dhënat e siguruara nga Zyra Arsimore Vendore përsa i përket komunitetit Rom dhe Egjiptian na rezulton se ndjekin arsimin 9-vjeçar 364 fëmijë të komunitetit romë dhe egjiptian, nga këto 44.7% femra. Ndërsa në arsimin e mesëm të përgjithshëm ndjekin shkollën 21 fëmijë, nga të cilët 16 prej tyre janë femra.

Ndjekin arsimin e mesëm profesional 15 fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilët përfitojnë bursë, ku 4 prej tyre janë femra.

Në kopshte dhe çerdhe janë të regjistruar dhe ndjekin rregullisht arsimin parashkollor 48 fëmijë, ku 22 prej tyre janë femra. Fëmijët e komunitetit të regjistruar në kopshte dhe çerdhe e përfitojnë falas shërbimin dhe nuk paguajnë tarifë mujore.

### 1.3 Kujdesi shëndetësor

Në Bashkinë Kamëz ushtrojnë aktivitetin 2 qendra të mëdha shëndetësore, 1 poliklinikë specialitetesh dhe disa qendra të tjera ambulatore që ofrojnë shërbimet shëndetësore pranë komuniteteve. Shërbimet për komunitetin Rom dhe Egjiptian mbulohen nga të gjitha qendrat shëndetësore në Bashkinë Kamëz.

Qendrat shëndetësore janë njësia bazë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Nga pikëpamja administrative, ato varen nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal[2] dhe financiarisht nga Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Çdo banor takimin e parë e merr në qendrën shëndetësore pranë së cilës është regjistruar nëpërmjet mjekut të familjes (të cilin e zgjedh vetë). Nëse mjeku i familjes gjykon qe diagnostikimi apo trajtimi i rastit kërkon konsultë më të specializuar, atëherë e rekomandon për tek specialisti përkatës. Për të gjithë personat e pajisur me kartë shëndeti mjeku specialist ofron shërbimin falas, ndërsa për të tjerët sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë[3]. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik[4].

Megjithatë deri më tani nuk ka statistika të sakta apo analiza studimore të kryera në lidhje me shëndetin e Romëve vihet re se treguesit e gjendjes shëndetësore të romëve po përkeqësohen krahasuar me treguesit e shëndetit të popullsisë së përgjithshme të vendit[5]. Romët kanë një incidencë më të lartë sëmundshmërie dhe janë më të prekshëm sidomos ndaj sëmundjeve të transmetueshme[6]. Është e gjithëpranuar se qasja në shërbimet shëndetësore të komunitetit Rom dhe Egjiptian është e shoqëruar më një seri problemesh dhe sfidash. Varfëria, kushtet e vështira të jetesës, pamundësia për të paguar për shërbimet dhe mjekimet, diskriminimi i hapur ose i fshehur, traditat dhe kultura e romëve dhe egjiptianëve (martesat dhe lindjet e hershme), niveli i ulët arsimor, mungesa e informacionit dhe njohurive rreth shëndetit riprodhues, shtatzanisë, sëmundjeve infektive dhe seksualisht të transmetueshme, lindjeve dhe kujdesit për fëmijët, ndryshimet e shpeshta të vendbanimeve, punët me risk të madh shëndetësor, kequshqyrja, trajtimi jo i mirë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, mungesa e kapaciteteve të personelit mjekësor, etj., përbëjnë shkaqet kryesore të qasjes së vështirë në shërbimet shëndetësore të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Në Bashkinë Kamëz po realizohet një studim në terren përsa i përket aspektit shëndetësor të familjeve Rome dhe Egjiptiane, në mënyrë që të mbledhim të dhëna statistikore dhe cilësore të sakta për krijimin e një database të saktë.

---

[2] Vendimi KM Nr. 394, datë 27.07.2000 Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës
[3] Urdhëri Nr 28, datë 26.01.2016 Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik
[4] Neni 23 (13) Ligji Nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore"
[5] http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/draft_strategjia/Draft_Strategjia_30Maj2016_web.pdf
[6] http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/draft_strategjia/Draft_Strategjia_30Maj2016_web.pdf

## 1.4 Punësimi, formimi dhe edukimi profesional

Varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë ul ndjeshëm interesin e romëve dhe egjiptianëve për të përfunduar arsimin apo formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit. Edhe pse janë orientuar drejtë zyrës së punës dhe anë referuar në programin e nxitjes së punësimit, ata gjejnë zgjidhje alternative që shpesh janë informale. Sektorët informalë, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo veprimtari të tjera që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë.

Megjithatë Bashkia Kamëz në bashkëpunim me zyrat e punës dhe nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit ka të punësuar në administratën e saj 70 punonjës të komunitetit Rom dhe Egjiptian, kryesisht në Ndërmarrjen e Pastrimit, Ndërmarrjen e Gjelbërimit dhe Ujësjellës Kanalizime Kamëz.

Bashkia Kamëz referuar dhe pesë programeve kryesore të punësimit të qeverisë ka një bashkëpunim të ngushtë me zyrat e punës në mënyrë që të rritet numri i të punësuarëve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian jo vetëm në sektorin publik por dhe atë privat. Gjithashtu vihet theksi tek referimi dhe regjistrimi pranë Qendrave të Formimit Profesional në Tiranë (nr 1 dhe 4), në vartësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Qendrat nëpërmjet dhjetra kurseve kontribuojnë në përgatitjen e punëtorëve dhe zanatçinjve profesionistë për tregun e punës.

Bashkia Kamëz për të promovuar rritjen e iniciativave private në biznes ka krijuar disa lehtësira për taksat e bizneseve të regjistruar dhe drejtuar nga persona të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Janë gjithsej 16 subjekte private të drejtuar nga anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilët kanë përfituar lehtësira fiskale dhe reduktim të taksave të biznesit.

Janë 4 subjekte private të cilat përfitojnë reduktim të tarifës dhe lehtësira fiskale për të siguruar rikuperim dhe qëndrueshmëri afatgjatë të biznesit. 4 subjekte të tjera kanë përfituar reduktim të taksave vendore në masën 50%. 5 subjekte private të drejtuar nga komuniteti Rom dhe Egjiptian janë mbështetur për tu formalizuar në biznese të rregullta. 2 biznese janë pajisur me leje për zhvillimin e aktiviteteve ambulatore në hapësirat publike dhe janë përjashtuar nga tarifat financiare. 1 subjekt i drejtuar nga anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian ka përfituar hapësirë tregtare të caktuar.

## 1.5 Strehimi

Plotësimi i nevojave të shtetasve për strehim është një nga objektivat sociale kushtetuese[7]. Për realizimin e këtij objektivi shteti ka krijuar tre programe sociale strehimi[8]: atë të banesave sociale me qera, të banesave me kosto të ulët dhe të pajisjes së truallit me infrastrukturë, të cilët shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve. Shteti gjithashtu ka krijuar gjashtë kategori ndihmash si bonus strehimi, subvencionim të qerasë, subvencionim të interesave të kredisë, grant të menjëhershëm, asistencë teknike dhe grante të vogla për zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit Rom. Nga këto programe përfitojnë individët mbi 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile të cilat që në momentin e aplikimit nuk kanë në pronësi një banesë, zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit ose kanë mbetur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore, për të tre rastet përfitues janë familjet që kanë të ardhura të pamjaftueshme.

Në Bashkinë Kamëz mbulohet programi i subvencionimit të qerasë në treg të lirë në të cilin përfitojnë bonus qeraje 11 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian, ndërsa 1 familje e komunitetit përfiton nga programi me kosto të ulët.

Gjithashtu programet e rindërtimit të banesave gjatë tërmetit të vitit 2019 kanë pasur një rol të rendësishëm në përmirësimin e kushteve të banesave për komunitetin Rom dhe Egjiptian. 66 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian në territorin e Bashkisë Kamëz janë përfituese të programeve të ndryshme nga proçesi i rindërtimit ku:

- 20 familje janë përfituese të programit DS1;
- 23 familje janë përfituese të programit DS2;
- 12 familje janë përfituese të programit DS3;
- 4 familje janë përfituese të programit DS4;
- 2 familje janë përfituese të programit DS5;
- 4 familje janë përfituese në zonën e re për zhvillim Valias;
- 1 familje është mbështetur me një grant prej 2.800.000L për ta rindërtuar banesën e dëmtuar vetë.

Një nga sfidat e strehimit mbetet informaliteti dhe pamundësia për të përbushur të gjitha dokumentat e kërkuara për të përfituar nga një nga programet e strehimit që bashkia ofron. Problem kryesor mbetet

[7] Neni 59 i Kushtetutës
[8] Neni 3 i Ligjit Nr.9232, datë 13.05.2004 "Për programet sociale të strehimit"

gjendja civile e familjeve e cila mund të jetë në një qytet tjetër dhe martesat në gjendje civile me persona të panjohur në këmbim të parave apo me persona të cilët janë larguar dhe nuk kanë më kontakt.

## 1.6 Mbrojtja sociale

Mbrojta sociale është një nga mekanizmat kryesore për zbutjen e varfërisë e përjashtimit social. Nëpërmjet komponentëve të tillë si të asistencës dhe programeve të mirëqenies sociale, mbrojtjes së fëmijëve, skemave të mbështetura në terren për të adresuar dhe trajtuar nevojat në nivel komunitar, ajo synon të sigurojë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit e përfshirjen sociale.

Kushtet e jetesës të romëve dhe egjiptianëve ndikohen nga mungesa e burimeve financiare për shkak të aksesit të kufizuar të tyre në punësim dhe sidomos në punësimin me pagesë. Për shkak të përjashtimit nga tregu formal i punës, ata janë futur në një rreth varfërie dhe përjashtimi social që i privon nga të gjitha mundësitë që do të kishin normalisht dhe i vështirëson kushtet e jetesës. Në rastet me nivel të lartë papunësie dhe të ardhura të ulëta nga puna me pagesë, bonuset sociale synohet të mbulojnë nevojat bazë të familjeve. Kushti për të përfituar ndihmë sociale, në rastet kur ka dispozita të tilla, është që familjet të regjistrohen në sistemin e ndihmës sociale.[9] Sipas një studimi të UNDP rezulton se 77.7% e familjeve rome dhe 84.1% e atyre egjiptiane bëjnë pjesë në grupin "shumë të varfër", ndërsa 6.1% e romëve dhe 7.8% e egjiptianëve janë të varfër.

Nga ana tjetër, një problematikë persistente për romët dhe egjiptianët për përfitimin e shërbimeve sociale (duke përfshirë ndihmën ekonomike) lidhet me mungesën e dokumenteve personale ose të transferimit formal të vendbanimit, analfabetizmit ose paaftësisë për të plotësuar formularët e aplikimit, procedurave tepër të komplikuara, pasja e pronësisë ligjore mbi toka që ata nuk i zotërojnë etj. Ndonjëherë, ata humbasin përfitimet për shkak të pamundësisë për të regjistruar transferimin e vendbanimit brenda afatit të caktuar. Skema e re e reformuar e Ndihmës Ekonomike (NE), shmang deri diku kriteret përjashtuese dhe dokumentacionin e tepërt duke bërë të mundur që të gjenerohen të dhënave nga sistemet e tjera. Skema shmang paraqitjen e dokumenteve si çertifikata personale e familjare, vërtetimin e punëkërkuesit të papunë, librezën e punës, dokumentet e pronësie për automjet etj. Parimisht, ky ndryshim në skemën e NE i siguron përparësi romëve dhe egjiptianëve të cilët kishin problem sigurimin e dokumenteve të

[9] UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

nevojshme dhe të kuptuarit e procedurave administrative, megjithatë në praktikë ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.[10]

Në Bashkinë Kamëz referuar dhe kushteve të jetesës dhe mirëqënies sociale i jepet një rëndësi e veçantë anëtarëve të komuntetit Rom dhe Egjiptian. Përpos ndihmave monetare që përfitojnë nga sistemi i ndihmës ekonomike, fondi 6% apo ndihmë nga fondet e veçanta të bashkisë, anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian referohen për përfshirje në programe apo projekte të ndryshme të zhvilluara nga OJF të ndryshme. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazi Gjinore dhe Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Bashkinë Kamëz kanë bashkëpunim të ngushtë me të gjitha organizatat jo-fitimprurëse që operojnë në Bashkinë Kamëz në menyrë që të ndihmojnë anëtarët e komunitetit dhe familjet e tyre me shërbime të tjera të veçanta apo specifike (këshillim psikologjik (këshillim/mbështetje emocionale); shërbim ligjor (konsulencë dhe përfaqësim në gjykatë); asistim në komisariat; shërbimet e emergjencës; bonus qeraje në bashkëpunim me OJF; përfshirje në kurset profesionale; paketa ushqimore dhe higjeno-sanitare; pako/dhurata për fëmijët; mbështetje me medikamente/analiza shëndetësore; mbështetje në çanta/mjete didaktike; ofrimi i shërbimeve të tjera specifike sipas nevojës)

Në Bashkinë Kamëz përgjatë vitit 2024 kanë aplikuar në sistemin e ndihmë ekonomike 101 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian. 58 familje të komunitetit (251 anëtarë) kanë përfituar ndihmën ekonomike.

- 46 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian (211 anëtarë) trajtohen me ndihmë ekonomike nga Sistemi Elektronik i Ndihmës Ekonomike.
- 5 familje (6 anëtarë) të komunitetit Rom dhe Egjiptian trajtohen me ndihmë ekonomike nga Fondi 6% i Bllok- Ndihmës Ekonomike.
- 7 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian (34 anëtarë) trajtohen me ndihmë ekonomike nga Fondi i Buxhetit të Bashkisë Kamëz.

Nga MKR është mbështetur 1 person i komunitetit dhe 2 persona të komunitetit janë të pajisur me UMM dhe UM.
